

Respecting Choices®

Planifikim paraprak i kujdesit shëndetësor

Mbani një dokument të ngarkuar në kartelën tuaj shëndetësore elektronike.



Përdorni një nga këto tri mënyra:

Faks: **947.522.0473**

Paraqit: **përmes MyChart**

Email: **cheadvancedirectivefax@corewellhealth.org**

Çfarë është planifikimi paraprak i kujdesit shëndetësor?

Planifikimi paraprak i kujdesit shëndetësor fillon me një bisedë. Ndërmjetësuesit e certifikuar të Respecting Choices janë në dispozicion për t'ju ndihmuar gjatë procesit. Kjo përfshin të ndani vlerat dhe bindjet tuaja me avokatin që keni zgjedhur për pacientin dhe me mjekun tuaj. Nëse e plotësoni me sukses, ai do të konsiderohet një dokument ligjor i direktivës paraprake.

Çfarë është një direktivë paraprake?

Direktiva paraprake është një dokument ligjor në të cilën tregohen preferencat tuaja specifike lidhur me trajtimet mjekësore në rast se nuk jeni në gjendje t'i shprehni vetë ato. Direktiva juaj paraprake, e quajtur gjithashtu "prokurë e kujdesit shëndetësor", do të përdoret vetëm nëse ju sëmureni ose lëndoheni kaq rëndë sa që nuk mund t'i shprehni vetë dëshirat tuaja. Direktiva paraprake fillon me një listë ku tregohet emri i avokatit të pacientit i cili do të marrë vendime për ju kur ju të mos jeni më në gjendje, gjithashtu përfshin dokumentacion opsional shtesë lidhur me preferencat për rigjallërim kardiopulmonar (CPR), Sistemin mbështetës për të ruajtur funksionet jetësore dhe dhurimin e organeve.

Shprehja e dëshirave dhe vendimeve tuaja

- Tregojuni familjarëve dhe miqve se keni plotësuar këtë dokument. Tregojuni kush është ose kush janë avokatët tuaj dhe cilat janë dëshirat tuaja lidhur me kujdesin shëndetësor.
- Merrni me vete një kopje të direktivës paraprake sa herë që shtroheni në një qendër shëndetësore dhe kërkoni që të përfshihet në kartelën tuaj shëndetësore elektronike.
- Mbani një kopje të direktivës suaj paraprake në një vend ku mund të gjendet me lehtësi.
- Mund të bëni ndryshime në direktivën tuaj

Rekomandojmë që ta përditësoni dokumentin tuaj çdo pak vjet, ose ndiqni **rregullin 5D**:

- Çdo **dekadë të jetës suaj**.
- Pas **vdekjes (death)** së një personi të dashur.
- Pas një **shkurorëzimi (divorce)**.
- Pas një **diagnostifikimi të rëndësishëm**.
- Pas ndonjë **dobësimi të konsiderueshëm në funksionimin tuaj**.

Formulari i direktivës paraprake mund të gjendet online, së bashku me informacione shtesë.



Për të folur me një ndërmjetës të certifikuar, ju lutemi na kontaktoni në: Telefon: **947.522.1948**

Email: **advancecareplanningeast@corewellhealth.org**

Faqe interneti: **beaumont.org/respecting-choices**

